



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

## NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Elmtronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited.

Me shkresën nr.544 prot., i AK, datë 24.12.2021, “Njoftim përqendrimi: Blerja e Elmtronics Group Limited nga Mer UK Holding Limited (një filial i Statkraft)”, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Elmtronics Group Limited nga shoqëria Mer UK Holding Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjithë aksioneve të emetuara të kapitalit të Elmtronics Group Limited”, palët janë:

**Blerësi:** Mer UK Holding Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: zotërimi, furnizimi, instalimi dhe operimi i pikave të karikimit të automjeteve elektrike për klientë në UK si për përdorim publik ashtu edhe për privat.

Mer UK Holding Limited është një filial i shoqërisë Statkraft AS, e cila është e pranishme në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara indirekt prej saj: Statkraft Renewables Albania SHPK, dhe Devoll Hydropower SHA.

**Pala shitëse** përfshin tre Shitësit Institucionalë dhe shtatë Shitës individualë.

**Target:** Elmtronics UK Holding Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: furnizimin dhe instalimin e pikave të karikimit të makinave elektrike si për konsumatorë ashtu edhe për klientë tregtarë.

Targeti dhe filialet e tij nuk kanë asnjë aktivitet dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**